Seancës Plenare

KUVENDI
NR 1046 DATE 20.03.24

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

Nr._____ prot

Tiranë, më __/__ 2024

Lënda: Amendament për projektligjin "Për sigurinë kibernetike"

KRYETARES SË KUVENDIT TË SHQIPËRISË
Sh.S. Znj. Lindita Nikolla

Mbështetur në nenin 75, pika 4, të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, propozoj që në projektligjin "Për sigurinë kibernetike" të bëhet ndryshimet e mëposhtme:

- **Në nenin 11, të projektligjit të ndryshohet gërma (b) pikat (vi) dhe (viii) më përmbajtje si vijon:**

Neni 11

(vi) subjektet që ofrojnë shërbime në sektorët e mjedisit, mbrojtjes së territorit dhe autoritetet territoriale përgjegjëse për furnizimin dhe shpërndarjen e ujit të pijshëm;

(viii) subjektet që ofrojnë shërbime në sektorin arsimor kur kryejnë veprimtari kërkimore kritike;

- **Në aneksin I, të projektligjit të bëhen ndryshimet si vijon:**

Të hiqen dy rreshtat e fundit "sektori arsimor" dhe "turizmi"

- **Në aneksin II, të projektligjit të bëhen ndryshimet si vijon:**

Të hiqet rreshti i fundit "sektori arsimor"

DEPUTETI PROPOZUES

Jorida TABAKU

RELACION

Amendamenti propozon ndryshimin e nenit 11 të projektligjit, përsa i përket gërmës (b) pikat (vi dhe (viii) si dhe ndryshimin e aneksit I dhe aneksit II duke i përafruar ato me nenin 2 pika 5 gërma (b) dhe Anekset I dhe II të **Direktivës (BE) Nr.2022/2555** të Parlamentit dhe Këshillit Evropian, datë 14 dhjetor 2022 "Mbi Masat për një nivel të lartë të përbashkët të sigurisë kibernetike në të gjithë Bashkimin Evropian.

Së pari, përsa i përket ndyrshimit të nenit 11 gërma (b) pika (vi), në këtë dispozitë të ndryshuar është propozuar heqja e fjalës "turizmi". Ky ndryshon *par effect* shoqërohet edhe me ndryshimin e ankesit I të projektligjit duke hequr rreshtin "turizmi" edhe nga aneksi.

Ky propozim është bërë duke qenë se direktiva nr. 2022/2555 në asnjë dispozitë të saj nuk e ka përfshirë sektorin e turizmit te sektorët me kritikalitet të lartë për efekt të ligjit për sigurinë kibernetike. Kështu në këtë direktivë në Aneksin I nuk është përfshirë turzimi në ndryshim me projektligjin e propozuar i cili e ka shtuar këtë sektor, pra subjektet që ofrojnë shërbime në sektorin e turizmit, përtej parashikimeve të Direktivës.

Së dyti, përsa i përket ndryshimit të nenit 11, gërma (b) pika (viii), në këtë dispozitë të ndryshuar është propozuar që sektori i arsimit të jetë i përfshirë vetëm përsa i përket rasteve kur ata përfshihen në veprimtari kërkimore kritike duke e sjellë kështu në përputhje me nenin 2 pika 5 gërma (b) të Direktivës nr. 2022/2055.

Ky ndryshim i sipërcituar automatikisht do të kërkojë edhe ndryshimin e Anekseve I dhe II duke hequr nga këto anekse rreshtin “sektori arsimor”. Ky ndryshim po ashtu do e sillte projektligjin në përafrim të plotë me Direktivën nr. 2022/2555 e cila nuk e ka sektorin arsimor të përfshirë në asnjë prej anekseve I dhe II të saj.

Qëllimi i legjislatorit të BE nuk është përfshirja e sektorit arsimor në vetëvete por mbrojtja e të dhënave të këtij sektori kur këta të fundit kryejnë aktivitet kërkimor kritik. Pra është kërkimi kritik objekt i legjislacionit dhe jo sektori arsimor.

Vë në vëmendje se përfshirja e sektorit arsimor përtej rasteve kur këta të fundit kryejnë veprimtari kërkimore kritike, bie ndesh/krijon konfuzion edhe me nenin 5 pika 27 të vetë ligjit (nenin 6 pika 41 e Direktivës nr. 2022/2555) i cili thotë se:

“‘Organizatë kërkimore’ një subjekt që ka si qëllim parësor të kryejë kërkime zhvillimi të aplikuara ose eksperimentale me synimin për të shfrytëzuar rezultatet e atij kërkimi për qëllime komerciale por që nuk përfshijnë institucionet arsimore.”

Kështu Direktiva nr. 2022/2555 jo vetëm që nuk i përfshin institucionet arsimore në Aneksin I dhe II përkatës por kur definon termin ‘Organizatë Kërkimore’ sigurohet në mënyrë të shprehur që ky definicion mos të përfshijë indirekt institucionet arsimore.

Po ti referohemi edhe mënyrës se si vendet anëtare po e implementojnë Direktivën nr. 2022/2555, shohim se Hungaria (https://net.jogtar.hu/jogszabaly?docid=a2300023.tv), Cekia (https://osveta.nukib.cz/pluginfile.php/102242/course/section/1460/Decree-regulated-services-eng.pdf?time=1689853110249), Gjermania, Irlanda, Danimarka, Findlanda dhe Hollanda të cilat i kanë miratuar ose janë në fazën e draft propozimit të kësaj Direktive, në vendet e tyre, kanë përfshirë të njëjtën listë sektorësh si Direktiva pra pa përfshirë sektorin e arsimit dhe atë të turizmit.

Historia jonë jo shumë e largët ka treguar që informacionet mbi të dhëna sensitive bien shpesh në duar të gabuara dhe për rrjedhojë centralizimi i tyre është thikë me dy presa. Nga njëra anë rritet siguria e të dhënave dhe infrastrukturave kritike të informacionit të rëndësishëm për sigurinë kombëtare por nga ana tjetër rritet aksesi mbi këto të dhëna nga institucione të centralizuara publike të cilat jo pak herë i kanë përdorur këto të dhëna për interesa të tjera (mbajmë në konsideratë sulmet e vitit të fundit mbi sistemet e-albania dhe në veçanti ndërhyrjen e paligjshme në sistemin TIMS për të cilin ka dhe një kallëzim penal pranë SPAK ndaj drejtuesit të Forcës Operacionale). Duke mbajtur këto të fundit në konsideratë, ka një rrezik të shtuar që këto të dhëna të sulmohen dhe të keqpërdoren në të ardhmen. Në këtë kuptim, zgjerimi përtej listës së parashtruar në Direktivë dhe kur të gjitha vendet e BE i kanë qëndruar në mënyrë të kufizuar vetëm këtyre sektorëve është e pavend, në kushtet kur, Shqipëria që ofron infrastrukturë dhe standart të ulët të sigurisë kibernetike të zgjerojë listën e sektorëve të prekur nga ky Projektligj.